



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.06.2018, ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit tre-javor i punimeve të Komisionit
2. Miratimi i procesverbaleve të datave 29 dhe 31 Maj 2018
3. Projektligji “Për ratifikimin e korigjimit të marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar”
4. Çështje të tjera

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Klajda Gjoshaj, Edi Paloka, Ervin Bushati, Xhemal Qefalia, Edmond Panariti

Mungojnë

Tritan Shehu, Nard Ndoka, Rudina Hajdari, Klevis Balliu, Evis Kushi

Të ftuar:

Tedi Bushaj - Shef Sektori i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita!

Fillojmë sot mbledhjen e datës 28 qershor 2018 të Komisionit për Politikën e Jashtme për dhënie mendimi për projektligjin “Për ratifikimin e korrigjimit të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BERZH-it për huanë e politikës së zhvillimit të sektorit financiar”.

Të ftuar kemi zotin Tedi Bushaj nga Ministria e Ekonomisë dhe Financës. Ndërkohë fillojmë rendin e ditës me miratimin e kalendarit tri-javor të punimeve të Komisionit. Nëse të gjithë jemi dakord, kalojmë te miratimi i procesverbaleve të datave 29 dhe 31 maj.

A jeni dakord?

Miratohen.

Fillojmë me diskutimin e projektligjit.

Zoti Bushaj, fjala për ju.

Tedi Bushaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BERZH-it për huanë e politikës së zhvillimit të sektorit financiar është ratifikuar me ligjin nr. 54” te vitit 2017. Nëpërmjet këtij projektakti synojmë korrigjimin e një lapsusi të BB-së që ka të bëjë realisht me ripagësën në përqindje dhe datën e futjes në pagesë mes palëve, e cila ndryshon nga data 15 shtator 2048 në 15 mars 2048, data e fundit e shlyerjes së principalit.

Aktualisht kjo kredi e akorduar nëpërmjet kësaj marrëveshjeje është disbursuar plotësisht, janë reflektuar dhe mendimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Punëve të Jashtme për ta kaluar këtë korrigjim me ligj, ashtu siç ka kaluar edhe marrëveshja bazë. Ne ia paraqesim këtij komisioni për miratim.

Mimi Kodheli – Përtej ndryshimit të datës, ju keni edhe një ndryshim të interesit, që ju mendoni se është një gabim i bankës, i cili nis nga lapsusi i BB-së. Unë do të kërkoja nga ju një angazhim që banka t’i drejtohet zyrtarisht parlamentit shqiptar dhe komisioneve respektive për dy gabime të cilat afektojnë këtë projektligj dhe si rrjedhojë afektojnë edhe diskutimin dhe miratimin në parlament si të datës, ashtu dhe të interesit, me justifikimin përkatës të bankës arsyet pse ky projektligj vjen me këto ndryshime në parlament. Mendoj se kjo është një gjë e bëshme dhe i kërkoj komisionit që ky projektligj të hyjë në diskutim vetëm pasi banka të ketë sjellë justifikimin zyrtar pranë komisioneve dhe parlamentit lidhur me çfarë po prezantoni sot, pra, një informacion shtesë, një letër zyrtare mbi informacionin lidhur

me ndryshimin e datës dhe të interesit, përndryshe projektligji nuk futet në seancë parlamentare për diskutim.

E miratojmë në parim dhe ndërkohë do të kemi këtë vëzhgim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, do t'ia kalojmë këtë sugjerim Komisionit të Ekonomisë, që është komisioni përgjegjës. Ndërkohë ju përgatituni për informacion!

Ne jemi dakord në përgjithësi me projektligjin.

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ka vetëm ndy nene.

Kush është dakord me nenin 1 të projektligjit?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2 të projektligjit, që është hyrja në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Nëse ka ndonjë gjë tjetër për të shtuar, apo ndonjë koment, kolegët e nderuar mund ta shprehin para se ta mbyllim mbledhjen.

Nuk ka.

Ndërkohë referojuni titullarit tuaj lidhur me çfarë kërkuam, se përndryshe nuk kalon!

Atëherë faleminderit zoti Bushaj për pjesëmarrjen tuaj!

Ju uroj punë të mbarë!

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA